

9 vjetori i Themelimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan

I nderuar Rektor Kosumi,
Të nderuar anëtar të Këshillit Drejtues,
I nderuar Kryetar i Komunës z. Hyseni,
Të nderuar profesor, staf i administratës, sekretar, studentë, të nderuar zonja dhe zotërinj.

Më lejoni që fillimisht në emrin tim dhe në emër të Këshillit Drejtues të ju uroj 9 vjetorin e Themelimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

Nuk preferoj të zgjatëm në fjalime, mirëpo siç e do rendi dua të them disa fjalë për arsimin dhe UKZ që sot mbush 9 vjet nga themelimi.

Unë i takoj gjeneratës të parë kur pas luftës së fundit, luftës së tmerrshme u regjistruam në Universitet, megjithatë, unë i takoj po kësaj gjenerate ku arsimimi ynë dhe i gjithë kombit tonë po pamundësohej dhe pengohej vazhdimisht nga okupatori Serb.

Sot, fatmirësisht gjendemi në rrethana krejt tjera, ku përveç mundësisë për tu arsimuar kemi edhe mundësinë për të zgjedhur se ku duam të arsimohemi. Sot, të dashur zonja dhe zotërinj, jetojmë një epokë ku mundësia për të studiuar është më e madhe se kurrë, është më e mundshme se kurrë më parë. Sot në një treg të hapur e dinamik si kurrë më parë, universitetet ballafaqohen me kërkesën dinamike të tregut për kualifikime që kërkon ky treg e që vazhdimisht po ndryshon.

Megjithatë, sot Kosova në 14 vjetorin e shtetësisë së saj, njëra ndër sfidat më të mëdha të këtij vendi mbetet arsimit. Edhe sot, që po vij nga dy ditë punëtori me MASHTI-n në hartimin e Strategjisë së re të Arsimit shohim dhe të gjithë fatkeqësisht pajtohemi se Cilësia e Arsimit në Kosovë mbetet ende larg asaj të dëshiruarës.

Sot, kur nevoja për arsim cilësor është me e madhe se kurrë më parë, ku nuk mjafton vetëm të kesh një diplomë, ku tregu i punës gjithnjë e më shumë po bëhet më konkurrues, ku biznesi dhe ndërmarrjet synojnë punësimin e më të mirëve pavarësisht nivelit të shkathtësive që i kërkon pozita e punës. Sfida e

universitetit mbetet, si të përgjigjemi këtij tregu, e këtu nuk bën përjashtim as UKZ dhe as një universitet tjetër.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Nga emërimi im në cilësinë e Anëtarit dhe kryesuesit të Këshillit Drejtues të Universitetit “Kadri Zeka” jam mundur për gjatë kësaj periudhe të kuptoj edhe më shumë për UKZ, për mundësitë që ka UKZ, për atë që mund të ofrojë UKZ, për të ndërtuar një vizion se ku do doja ta shihja UKZ.

Kam parë shumë sfida, jam njoftuar nga Rektori, kolegët e KD për sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohet UKZ-ja, filluar nga mungesa e kampusit, zgjerimi i kapaciteteve, përgjigja e kërkesave të tregut me profile dhe drejtime të konkurrueshme, ballafaqimi me kërkesat e akreditimit, si dhe shumë çështje tjera. Megjithatë, nga biseda që kam patur me profesor, studentë e staf administrativ të UKZ kam parë shumë vullnet, e dëshirë për të ecur tutje për të qar UKZ aty ku të gjithë do të dëshironim, për të përafhua UKZ me universitetet evropiane, aty ku aspirojmë të jemi si shtet, në familjen evropiane.

Më lejoni që nga këndvështrimi i Ministrisë së Arsimit, nga takimet me ministren Nagavci, kabinetin e saj, nga objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Re të Arsimit 2022-2026, të ju njoftoj për synimet e reja që MASHT ka për arsimin në Kosovë. Nga objektivat e përcaktuara në PSAK dhe nga konstituimi i aktiviteteve që kemi bërë rezulton se një buxhet i kërkuar prej 314 milion euro shtesë, e ku për arsimin e lartë kërkohen rreth 55 milion, që nëse mbetet të jetë ky buxhet apo i përafërt, atëherë do të jetë buxheti më i lartë ndonjë herë i dedikuar për arsim, edhe pse prapë mund të themi se ky buxhet nuk është i mjaftueshëm.

Më lejoni që për fund para se të përfundoj fjalën time, të shpreh një falënderim për gjithë kolegët nga KD, profesorët dhe stafin e administratës së UKZ, dhe gjithë tjerët të cilët po angazhohen për të ndryshuar dhe përmirësuar UKZ-në e që ju them se jam shumë optimist se përvjetorët e ardhshëm do ta gjejnë UKZ gjithnjë e më mirë, gjithnjë e më lartë të ranguar dhe jam shumë optimist se shumë shpejtë edhe me kampus të ri.

Të nderuar profesor, student dhe staf i administratës, të nderuar zonja dhe zotërinj, Urime 9 Vjetori i Themelimit të Universitetit Kadri Zeka.

Ju faleminderit!